Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0256
Data e Vendimit: 08.05.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 7 dhe neni 109 paragrafi 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të kërkesës së datës 04/05/2023 për tërheqje nga ankesa të parashtruar nga OE "ER – LIS" SH.P.K., me nr. 2023/0256 kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve Lot 1 - Mirëmbajtja e rrugëve në Qytet Lot 2 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave Lot 3 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave të Rugovës" me numër të prokurimit 635-22-11224-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 08/05/2023, mori këtë:

Vendim

Aprovohet, kërkesa e datës 04/05/2023, e parashtruar nga "ER – LIS" SH.P.K., për tërheqjen e ankesës me nr. 2023/0256, e datës 04/05/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve Lot 1 - Mirëmbajtja e rrugëve në Qytet Lot 2 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave Lot 3 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave të Rugovës", me numër të prokurimit 635-22-11224-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës.

Arsyetim

Operatori ekonomik "ER–LIS" SH.P.K, me 04/05/2023 ka paraqitur ankesë në OSHP kundër Vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dimërore e Rrugëve Lot 1 - Mirëmbajtja e rrugëve në Qytet Lot 2 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave Lot 3 - Mirëmbajtja e rrugëve të fshatrave të Rugovës" me Nr. të prokurimit 635-22-11224-2-1-1, iniciuar nga Komuna e Pejës në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK) duke pretenduar në shkelje

të neneve 1, 7, 10, 59, 69, 71, 72, 116, 130 të LPP-së.

OE "ER–LIS" SH.P.K, me 04.05.2023 në sistemin e-prokurim kishte tërhequr ankesën me numër 2023/0256 të cilën po atë ditë e kishte parashtruar pra me datë 04.05.2023. Me arsyetimin se i njëjti OE kishte parashtruar edhe një ankesë tjetër në OSHP (Nr. protokolli 2023/0254) për të njëjtin aktivitet të prokurimit.

Zyra Ligjore pas verifikimit në sistemin elektronik për ankesën në fjalë ka konstatuar se tek rubrika e ankesave figuron se ankesa e lartcekur është tërhequr nga OE ankues me datë 04.05.2023 kurse pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankues "ER–LIS" SH.P.K, bazuar në arsyen e lartcekur, se po për të njëjtin aktivitet të prokurimit janë paraqitur dy ankesa, kanë rekomanduar që të aprovohet si e bazuar kërkesa e Ankuesit për tërheqje nga ankesa dhe pretendimet ankimore të ankesës nr. 2023/0256 të datës 04.05.2023.

Meqenëse OE ka paguar vetëm një tarifë për këtë aktivitet të prokurimit, e njëjta vlen për ankesën me numër protokolli 2023/0254 e cila do të shqyrtohet në mënyrë të rregullt nga OSHP.

Kryetarja e OSHP mbi bazën e të lartëcekurave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PEJES**
- OE - **ER - LIS SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: